



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njsela:	<u>KO</u>	Nr. Prot.:	<u>22/2019</u>
Unit:		Prot. No.:	
Jednica:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:	<u>-22-</u>	Data:	<u>19.02.2019</u>
No. of pages:		Datum:	
En shënime:		Prishtinë/g	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REGULLORE PËR
REGJISTRIMIN, LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E MJEKËVE

Janar, 2019

Prishtinë

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK) në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 lidhur me nenin 9, paragrafin 1, me nënparagrafin 1.3 të Ligjit nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësorë, nenit 22, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 dhe në lidhje me nenin 17, paragrafin 1, me nënparagrafin 1.3 të Statutit të OMK-së dhe nenin 6, paragrafin 3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, e miratuar në mbledhjen e datës 19 qershor 2018, e plotësuar dhe e ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 17 janar 2019, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

**R R E G U L L O R E P Ë R
REGJISTRIMIN, LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E MJEKËVE**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 14/2019 të Kuvendit të OMK-së, datë 17 janar 2019)

Kapitulli I - Dispozita të përgjithshme

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyrat dhe kriteret e regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të doktorëve të mjekësisë, si dhe specialistëve dhe subspecialistëve të lëmenjve përkatës mjekësorë. Po ashtu me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e menaxhimit të regjistrave përkatës në të cilët mbahet evidenca e të gjithë mjekëve që posedojnë licencën, përfshirë mjekët të cilët kanë qenë posedues të licencës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet për procedurat e regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të mjekëve, specialistëve, si dhe subspecialistëve të lëmenjve përkatës të mjekësisë.
2. Kjo Rregullore përfshin dispozita edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me procesin e licencimit dhe rilicencimit të profesionistëve të mjekësisë.
3. Kjo rregullore nuk zbatohet për licencimin dhe rilicencimin e mjekëve me shtetësi të huaj. Licencimi dhe rilicencimi i shtetasve të huaj rregullohet me akt të veçantë nënligjor të përgatitur

Neni 3

Përkufizimet

1. Termat dhe akronimet të përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1 **Mjeku** – nënkupton doktorin e mjekësisë, i cili ka përfunduar programin universitar në arsimim të lartë në ndonjërin nga institucionet e arsimit të lartë të akredituar nga organi kompetent;
- 1.2 **Specialisti** – nënkupton mjekun e specializuar në ndonjërin nga lëmenjtë e fushës së mjekësisë;
- 1.3 **Subspecialist** – nënkupton mjekun i cili ka kryer program të caktuar të shkollimit sipas programeve të parapara për lëmenj të ngushtë specialistikë, për fushë të caktuar mjekësore;
- 1.4 **Faksimilja** – nënkupton vulën unike, të cilën i licencuari e përdor me rastin e lëshimit të dokumenteve dhe raporteve mjekësore në bashkëngjitje të nënshkrimit personal;
- 1.5 **OMK** – nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;
- 1.6 **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional; dhe
- 1.7 **MSh** – nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë;

2. Termat dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Kapitulli II – Komisioni për Licencim

Neni 4

Kompetencat dhe përgjegjësitë

- 1. Komisioni për Licencim është komision i përhershëm i OMK-së i cili, në bazë të autorizimeve ligjore që i janë besuar OMK-së për të ushtruar kompetencat publike, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1 Mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe anëtarësimit të mjekëve në OMK;
 - 1.2 Mirëmban dhe menaxhon bazën e të dhënave përkitazi me regjistrin e mjekëve, regjistrin e mjekëve të licencuar dhe të rilicencuar;
 - 1.3 Vendosi në shkallë të parë mbi përmbushjen e kushteve për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin e mjekëve;

- 1.4 Udhëheq procesin e licencimit dhe rilicencimit të mjekëve;
 - 1.5 Me aprovimin përfundimtar të kryetarit të OMK-së lëshon certifikatat e licencave;
 - 1.6 Ekzekuton masat disiplinore lidhur me tërheqjen e përkohshme dhe të përhershme të licencës dhe fshirjen nga regjistri i anëtarëve të Odës, në bazë të vendimit të formës së prerë të Këshillit Etik apo Gjyqit të Nderit; Bashkëpunon me organet e tjera të OMK-së me qëllim të përmbushjes së funksioneve të përgjithshme të OMK-së; dhe
 - 1.7 Kryen detyra të tjera sipas akteve normative të miratuara nga organi kompetent i OMK-së.
2. Komisionit për licencim mund t'i barten edhe përgjegjësi të tjera nga organet e OMK-së në përshtatje me natyrën e funksioneve themelore të parapara me këtë nen.

Neni 5

Përbërja dhe zgjedhja e Komisionit për Licencim

1. Komisioni për Licencim përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OMK-së, nga radhët e anëtarëve të OMK-së.
2. Anëtarët e Komisionit për Licencim kanë mandat 4 (katër)- vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat në vazhdim.
3. Mënyra e zgjedhjes, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit për Licencim rregullohet me akt të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të OMK-së.

Kapitulli III – Regjistrimi i mjekëve

Neni 6

Regjistri i anëtarëve

1. Të gjithë mjekët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale dhe të gjithë ata që kryejnë veprimtari të tjera nga veprimtaria shëndetësore në Republikën e Kosovës janë të obliguar që të regjistrohen dhe të anëtarësohen në Odën e Mjekëve të Kosovës (OMK).
2. Komisioni për Licencim është organ kompetent i OMK-së, i cili bën regjistrimin dhe mirëmban regjistrat e mjekëve që anëtarësohen në OMK.

3. Komisioni për Licencim me rastin e regjistrimit të mjekut në OMK vlerëson përmbushjen e kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore për fitimin e statusit të anëtarit të OMK-së.
4. Vetëm pas verifikimit të plotësimit të kushteve nga ana e Komisionit për Licencim, parashtruesi i formularit për anëtarësim regjistrohet në regjistrin e anëtarëve të OMK-së, që përndryshe përbën regjistrin e profesionistëve të lëmenjve të mjekësisë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 7

Procedura e regjistrimit

1. Procedura e regjistrimit iniciohet me dorëzimin e formularit për anëtarësim në OMK (Shtojca I), të cilin e plotëson personalisht mjeku që ka për detyrim ligjor anëtarësimin në OMK.
2. Formulari për anëtarësim do të përmbajë të dhënat personale si në vijim:
 - 2.1 Emri, emri i prindit dhe mbiemri;
 - 2.2 Data e lindjes;
 - 2.3 Numri personal;
 - 2.4 Shtetësia;
 - 2.5 Emri dhe adresa e institucionit ku ushtrohet veprimtaria;
 - 2.6 Tek mjekët që janë të punësuar në sektorin publik shënohet numri i pagës (EM);
 - 2.7 Statusi profesional/specialistik;
 - 2.8 Adresa aktuale;
 - 2.9 Të dhënat mbi komunikim, që përfshijnë numrin e telefonit dhe/ose të zyrës, apo ai personal, dhe adresa e postës elektronike;
3. Formularit për anëtarësim duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
 - 3.1 Dy (2) fotografi me dimensione 3x4cm;
 - 3.2 Kopja e letërnjoftimit të afatizuar;
 - 3.3 Kopja e noterizuar e licencës, në rast se është posedues i saj; dhe
 - 3.4 Kopjet e noterizuara të diplomës së studimeve dhe dëshmi të tjera, të cilat vërtetojnë specializimin/aftësimin profesional dhe kualifikimin subspecialistik;
4. Formulari për anëtarësim duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet personalisht nga mjeku në zyrë të OMK-së. Shërbimi profesional i OMK-së do të procedojë formularin e tillë për shqyrtim në Komisionin për Licencim.
5. Të dhënat personale nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni do përpunohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Në rast të deklarimit të statusit si i papunësuar, aplikuesi duhet ta dorëzojë vërtetimin e organit kompetent të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me të cilin vërtetohet statusi i tillë social, vërtetimi mbi deklarimin tatimor dhe ekstrakti apo dokumenti relevant mbi llogarinë e pagesës së kontributeve pensionale të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës.

Neni 8

Anëtarësimi i mjekëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë Republikës së Kosovës

1. Mjekët me shtetësi të Republikës së Kosovës, të cilët ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe që shprehin vullnetin të regjistrohen dhe të anëtarësohen në Odë, mund të paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim në pajtim me kushtet siç janë paraparë me dispozitat e këtij neni, përkitazi me regjistrimin dhe anëtarësimin e mjekëve vendorë.
2. Procedura e regjistrimit dhe anëtarësimit do të bëhet në përputhje me dispozitat e neneve 6, 7 dhe 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Anëtarësimi i shtetasve të huaj

1. Mjekët që kanë shtetësi të huaj dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Kosovës janë të obliguar që të anëtarësohen në OMK.
2. Dispozitat lidhur me regjistrimin e mjekëve me shtetësi të Republikës së Kosovës zbatohen në mënyrë të përshtatshme tek regjistrimi i mjekëve me shtetësi të huaj, duke përfshirë kushtet shtesë si në vijim:
 - 2.1 Leja e qëndrimit e noterizuar në Republikën e Kosovës, në pajtim me Ligjin në fuqi për të huajt;
 - 2.2 Vërtetimi nga Oda e Mjekëve të vendit të origjinës, me të cilin vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin, nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore dhe se ndaj tij nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale;
 - 2.3 Barasvlerësimi i diplomës dhe certifikatave të kryera prej tij/saj, të përkthyer dhe të noterizuara;
 - 2.4 Kopja e noterizuar e licencës valide të punës nga vendi i origjinës, nëse është e aplikueshme;
 - 2.5 Njohja e ndonjërës nga gjuhët zyrtare, të vërtetuara nga organi kompetent; dhe
 - 2.6 Në rast se nuk njeh ndonjërën nga gjuhët zyrtare, të vërtetojë se ka siguruar përkthyesin e licencuar nga organi kompetent, i cili është i punësuar me orar të plotë në shërbim të mjekut të huaj, i cili aplikon për regjistrim dhe anëtarësim.
3. Regjistrimi i mjekëve me shtetësi të huaj bëhet sipas procedurës dhe mënyrës së njëjtë, për dallim që evidenca e regjistrimit të tyre menaxhohet në bazë të veçantë të të dhënave për profesionistët me shtetësi të huaj, që mbikëqyret nga Komisioni për Licencim.

Neni 10

Procedura e vendimmarrjes për regjistrim dhe anëtarësim

1. Shërbimi Profesional i OMK-së me rastin e pranimit të formularit për regjistrim, parashtruesit ia lëshon një vërtetim me të cilin dëshmohet dorëzimi i formularit për regjistrim dhe anëtarësim në OMK. Në këtë vërtetim shënohet data e dorëzimit, numri i protokollit, dokumentet e dorëzuara

- dhe numri i faqeve të dokumentacionit, si dhe emri dhe mbiemri i zyrtarit që ka pranuar formularin dhe dokumentacionin përcjellës.
2. Pas pranimit të dokumentacionit sipas paragrafit 1 të këtij neni, Shërbimi Profesional i OMK-së ia procedon Komisionit për Licencim për shqyrtimin e dosjes së dorëzuar.
 3. Komisioni për Licencim do të shqyrtojë dosjen e tillë dhe për regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit nxjerr vendim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e dorëzimit të formularit.
 4. Me rastin e nxjerrjes së vendimit mbi regjistrim dhe anëtarësim, Komisioni për Licencim mund që:
 - 4.1 Të aprovojë regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit;
 - 4.2 Të refuzojë regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj Rregulloreje; apo
 - 4.3 Të refuzojë regjistrimin e parashtruesit për shkak të ekzekutimit të masës disiplinore të heqjes nga regjistri.
 5. Komisioni për Licencim mundet që gjatë shqyrtimit të kërkojë nga parashtruesi që të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për regjistrim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 5 (pesë) ditëve, nga dita e njoftimit.
 6. Komisioni për Licencim do të konsultojë Komisionin Etik lidhur me evidencën e masave disiplinore për vërtetimin e faktit lidhur me zbatimin e masës disiplinore të heqjes nga regjistri të mjekut ndaj të cilit është shqiptuar masa e tillë disiplinore.
 7. Pala e pakënaqur ndaj vendimit të Komisionit për Licencim, sipas paragrafit 4 të këtij neni, mund të parashtrtojë ankesë në Këshillin Drejtues të OMK-së në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të vendimit.
 8. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen në përshtatshmëri ndaj mjekëve me shtetësi të huaj.

Neni 11

Çregjistrimi i vullnetshëm

1. I anëtarësuar, i cili për arsye të shprehjes së vullnetit dëshiron të bëjë çregjistrimin nga anëtarësimi në Odë, duhet ta dorëzojë kërkesën në formë të shkruar në të cilën paraqet arsyet e kërkesës për çregjistrim.
2. Çregjistrimi nga regjistri i anëtarësisë mund të bëhet vetëm nën arsye të heqjes dorë nga ushtrimi i veprimtarisë mjekësore.
3. Ndaj vendimit të Komisionit me të cilin refuzohet kërkesa për çregjistrim, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Këshillin Drejtues të Odës, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 12

Kartela e anëtarësisë

1. Me rastin e regjistrimit, të anëtarësuarit i lëshohet kartela identifikuese e anëtarësisë në të cilën shënohen:
 - 1.1 Emri dhe mbiemri;
 - 1.2 Numri i licencës;
 - 1.3 Data e lëshimit; dhe
 - 1.4 Numri rendor i anëtarësisë.
2. Përdorimi, posedimi, humbja apo dëmtimi i kartelës do të trajtohen në përshtatshmëri sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje për licencën.
3. Kartela e anëtarësisë është pronë e Odës dhe si e tillë duhet t'u dorëzohet organeve kompetente të Odës me rastin e skadimit të saj apo në rast të çregjistrimit të mjekut nga regjistri i anëtarësisë.

Neni 13

Zbatimi i masave disiplinore të shqiptuara nga organet e mbikëqyrjes etike dhe profesionale

1. Komisioni për Licencim është organi kompetent për ekzekutimin e masave disiplinore përkritazi me tërheqjen e përkohshme apo të përhershme të licencës dhe heqjes nga regjistri i mjekëve.
2. Komisioni për Licencim do të bëjë ekzekutimin e masës disiplinore sipas urdhrit të organit kompetent që ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren për Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale të OMK-së.
3. Me rastin e ekzekutimit të masës disiplinore sipas vendimit të organit kompetent, Komisioni për Licencim do të njoftojë Komisionin Etik për ekzekutimin e masës së tillë, në mënyrë që të bëhet evidentimi i ekzekutimit të masës disiplinore në regjistrin e veçantë për masat e shqiptuara disiplinore.

Neni 14

Gjobat ndëshkuese

1. Në rast se aplikuesi nuk e ka përfillur afatin e regjistrimit, respektivisht nga rrethanat kur janë të obliguar që të bëjnë regjistrimin, Komisioni do të shqiptojë gjobë ndëshkuese duke shqiptuar për çdo muaj gjobën në shumë prej 30 eurosh, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm në procedurë përmbartimore.
2. Komisioni me rastin e shqiptimit të gjobës ndëshkuese nxjerr vendim ndaj të cilit pala e pakënaqur ka të drejtë që të paraqesë ankesë në Këshillin Drejtues në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të vendimit.

Kapitulli IV – Licencimi i mjekëve

Neni 15 Detyrimi për licencim

1. Licencimi, respektivisht rilicencimi i mjekëve është i detyrueshëm për të gjithë mjekët për ushtrimin e veprimtarisë mjekësore sipas autorizimeve ligjore.
2. Licencimi është procedurë e veçantë administrative që ka karakter zyrtar dhe publik. Komisioni për Licencim udhëhiqet mbi bazën e parimeve në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.
3. Licenca e punës është dokument publik, i cili vërteton përmbushjen e kushteve nga ana e mjekut, e që janë përcaktuar në mënyrë taksative me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 16 Inicimi i procedurës për licencim

1. Procedura për licencim, qoftë licencimin e doktorit të mjekësisë, specialistit apo subspecialistit të lëmit përkatës mjekësor, dhe rilicencimi iniciohen me parashtrimin e aplikacionit që është shtojcë e kësaj rregulloreje (Shtojca II).
2. Parashtruesi i aplikacionit për rilicencim duhet ta parashtrojë aplikacionin për rilicencim më së voni 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të licencës. Në të kundërtën, ndaj parashtruesit do të shqiptohen gjobat administrative të parapara me këtë Rregullore.
3. Shërbimi Profesional i OMK-së me rastin e pranimit të aplikacionit parashtruesit ia lëshon një vërtetim me të cilin dëshmohet dorëzimi i aplikacionit për licencim, respektivisht për rilicencim. Në këtë vërtetim shënohen data e dorëzimit, numri i protokollit, dokumentet e dorëzuara dhe numri i faqeve të dokumentacionit, si dhe emri dhe mbiemri i zyrtarit që ka pranuar aplikacionin dhe dokumentacionin përcjellës.
4. Pas pranimit të dokumentacionit, sipas këtij neni, Shërbimi Profesional i OMK-së ia procedon Komisionit për Licencim për shqyrtimin e dosjes së dorëzuar.

5. Aplikacioni për licencim, respektivisht për rilicencim duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet personalisht nga parashtruesi.
6. Aplikacioni për licencim të doktorëve të mjekësisë, specialistëve dhe subspecialistëve të lëmenjve përkatës të mjekësisë procedohet drejtpërdrejt në Komisionin për Licencim.
7. Aplikacioni përkitazi me rilicencimin e doktorëve të mjekësisë, specialistëve dhe subspecialistëve të lëmenjve përkatës të mjekësisë procedohet paraprakisht tek Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional. Komisioni për EVP pasi që të nxjerrë vërtetimin për valorizimin e pikëve kredituese, dosja e tillë së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar me dispozita të kësaj Rregulloreje procedohet në Komisionin për Licencim.
8. Mënyra e vlerësimit kreditues lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional është nën përgjegjësinë e Komisionit për EVP dhe çështjet përkitazi me këtë procedurë rregullohen me akt të veçantë normativ.

Neni 17

Kushtet për licencim të doktorëve të mjekësisë

1. Kushtet për licencim të doktorëve të mjekësisë që duhet përmbushur janë:
 - 1.1 Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2 Të jetë i diplomuar në lëmin mjekësor në ndonjërin nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë apo të ketë të nostrifikuar programin universitar sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3 Të ketë dhënë provimin profesional;
 - 1.4 Të jetë i regjistruar dhe i anëtarësuar në OMK;
 - 1.5 Të ketë paguar kuotën e anëtarësisë në OMK; dhe
 - 1.6 Të ketë paguar taksën administrative për dorëzim të aplikacionit.
2. Për rilicencimin e doktorëve dhe specialistëve të mjekësisë, krahas kushteve të parapara me paragrafin 1 të këtij neni, parashtruesi i aplikacionit duhet të përmbushë së paku 100 (njëqind) pikë akredituese për edukimin e vazhdueshëm profesional gjatë ushtrimit të profesionit sipas licencës që i skadon kohëzgjatja. Valorizimi i pikëve akredituese bëhet nga Komisioni për EVP, me ç'rast aplikuesit i lëshohet akti me të cilin vërtetohet numri ekzakt i pikëve akredituese sipas aktiviteteve që janë kryer brenda periudhës përkatëse.

Neni 18

Përmbajta e aplikacionit dhe dokumentet për dorëzim lidhur me licencimin dhe rilicencimin e doktorëve të mjekësisë

1. Aplikacioni për licencim dhe rilicencim të doktorëve të mjekësisë përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 Emri i personit, emri i prindit dhe mbiemri;

- 1.2 Data e lindjes dhe vendi;
- 1.3 Adresa e vendbanimit;
- 1.4 Vendi dhe data e diplomimit;
- 1.5 Të dhënat mbi vendin e punës, respektivisht institucionin shëndetësor, nëse është në marrëdhënie të punës;
- 1.6 Numri i telefonit;
- 1.7 Adresa e emailit;
- 1.8 Vendi dhe data e diplomimit;
- 1.9 Emri dhe mbiemri, nënshkrimi, data e aplikimit.

2. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e licencimit të doktorit të mjekësisë janë:

- 2.1 Kopja e noterizuar e diplomës universitare në rast se aplikuesi ka përfunduar studimet jashtë vendit duhet dorëzuar vendimin e noterizuar të organit kompetent për nostrifikimin e diplomave të huaja;
- 2.2 Certifikata e noterizuar e provimit profesional;
- 2.3 Deklarata e nënshkruar nën betim;
- 2.4 Kopja e letërnjoftimit; dhe
- 2.5 Fletëpagesa për taksën administrative për licencim.

Neni 19

Përmbajta e aplikacionit dhe dokumentet për dorëzim lidhur me licencimin dhe rilicencimin e specialistëve dhe subspecialistëve të mjekësisë

1. Aplikacioni për licencim dhe rilicencim të specialistëve dhe subspecialistëve të mjekësisë përmban të dhënat e mëposhtme:

- 1.1 Emri i personit, emri i prindit dhe mbiemri;
- 1.2 Data e lindjes dhe vendi;
- 1.3 Adresa e vendbanimit;
- 1.4 Vendi dhe data e diplomimit;
- 1.5 Të dhënat mbi vendin e punës, respektivisht institucionin shëndetësor, nëse është në marrëdhënie të punës;
- 1.6 Lloji i specializimit;
- 1.7 Data e specializimit
- 1.8 Numri i telefonit;
- 1.9 Adresa e emailit;
- 1.10 Vendi dhe data e diplomimit;
- 1.11 Emri dhe mbiemri, nënshkrimi, data e aplikimit.

2. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e licencimit të doktorit të mjekësisë janë:

- 2.1 Kopja e noterizuar e diplomës universitare, në rast se aplikuesi ka përfunduar studimet jashtë vendit duhet dorëzuar vendimin e noterizuar të organit kompetent për nostrifikimin e diplomave të huaja;
- 2.2 Certifikata e noterizuar e provimit specialistik apo subspecialistik;
- 2.3 Deklarata e nënshkruar nën betim;
- 2.4 Kopja e letërnjoftimit; dhe

2.5 Fletëpagesa për taksën administrative për inicim të procedurës së licencimit.

Neni 20

Kushti i vazhdimësisë së ushtrimit të profesionit

1. Me rastin e licencimit dhe rilicencimit aplikuesi duhet që:
 - 1.1 Në rast të rilicencimit të dëshmojë se ka ushtruar profesionin në dy vjetët e fundit para parashtrimit të aplikacionit për rilicencim.
2. Nëse aplikuesi, qoftë në rast të licencimit për herë të parë, qoftë me rastin e rilicencimit, nuk e përmbush kushtin nga paragrafi 1 i këtij neni, do të obligohet që t'i nënshtrohet provimit profesional.
3. Aplikacionit të ripërsëritur për licencim apo rilicencim duhet t'i bashkëngjitet certifikata e dhënies së provimit profesional, krahas dokumentacionit të cekur sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 21

Vendimmarrja dhe lëshimi i licencës

1. Komisioni për Licencim do të shqyrtojë dokumentacionin së bashku me aplikacionin për licencim apo rilicencim dhe do të nxjerrë vendim për lëndën përkatëse në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e dorëzimit të formularit.
2. Me rastin e nxjerrjes së vendimit mbi licencim apo rilicencim, Komisioni mund që:
 - 2.1 Të aprovojë kërkesën për licencim apo rilicencim të aplikuesit;
 - 2.2 T'i japë afat në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve aplikuesit, i cili sipas vlerësimit të Komisionit për EVP nuk i ka përmbushur pikët e mjaftueshme për rilicencim, në mënyrë që në afatin e caktuar t'i përmbushë pikët e nevojshme për valorizim për fondin maksimal të pikëve për 1 (një) vit në total. Në rast se aplikuesi dështon që të përmbushë kushtin e caktuar nga Komisioni, rilicencimi i aplikuesit refuzohet nga Komisioni;
 - 2.3 Të refuzojë licencimin apo rilicencimin e aplikuesit për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj Rregulloreje; apo
 - 2.4 Të refuzojë licencimin apo rilicencimin për shkak të ekzekutimit të masës disiplinore, të heqjes nga regjistri ndaj aplikuesit.
3. Komisioni për licencim mundet që gjatë shqyrtimit të kërkojë nga parashtruesi të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për licencim apo rilicencim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit.

4. Pala e pakënaqur ndaj vendimit të Komisionit për Licencim, sipas paragrafit 2 të këtij neni, mund të parashtrojë ankesë në Këshillin Drejtues të OMK-së në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të vendimit.
5. Në bazë të vendimit të Komisionit për Licencim, kryetari i OMK-së dhe kryetari i Komisionit për Licencim e nënshkruajnë licencën e punës, e cila i dorëzohet personalisht parashtruesit. Me rastin e dorëzimit të licencës, dorëzimi i tillë do të evidentohet në regjistrin e pranim-dorëzimit të licencave.
6. Aplikuesi, i cili me rastin e dorëzimit të dokumentacionit për rilicencim nuk e ka dorëzuar licencën origjinale, këtë duhet ta bëjë me rastin e pranimi të licencës së lëshuar. Në të kundërtën, të njëjtit nuk mund t'i lejohet tërheqja e licencës.
7. Originali i licencës së skaduar, i cili dorëzohet nga aplikuesi, do të asgjësohet nga ana e Shërbimit Profesional të OMK-së.

Neni 22

Afat i licencave

1. Licenca për doktorët e mjekësisë dhe specialistët e lëmenjve përkatës të mjekësisë lëshohet në afat prej 5 (pesë) vjetëve, nga data e nënshkrimit të licencës nga ana e kryetarit të OMK-së dhe kryetarit të Komisionit për Licencim.
2. Përjashtimisht, nga paragrafi 1 i këtij neni, licenca mund të lëshohet në afat më të shkurtër me kërkesë të aplikuesit, nëse arsyeja ka të bëjë me pretendimin e fitimit të titullit specialistik.
3. Licenca e lëshuar, sipas paragrafit 2 të këtij neni, do të lëshohet në përputhje me vitin e fundit të programit specialistik, të cilit i nënshtrohet aplikuesi.

Neni 23

Licenca dhe përgjegjësia e përdorimit

1. Licenca e punës lëshohet në vetëm 1 (një) ekzemplar origjinal, që mund ta posedojë vetëm mjeku të cilit i lëshohet licenca.
2. Licenca në asnjë mënyrë nuk mund të përdoret nga ndonjë person tjetër në mënyrë që të arsyetojë ushtrimin e veprimtarisë mjekësore.
3. E drejta e njohur për të ushtruar veprimtari mjekësore në bazë të licencës së lëshuar nuk mund të bartet e as të autorizohet nga personi i tretë në shfrytëzimin e saj.
4. Përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e licencës është i licencuari sipas titullit në licencën e lëshuar.
5. Në rast të humbjes së licencës, i licencuari duhet ta njoftojë me shkrim OMK-në posa të jetë njoftuar me një rrethanë të tillë. I licencuari me rastin e humbjes së licencës është i obliguar që me rastin e njoftimit të OMK-së për humbjen e licencës, të bëjë publikimin e humbjes së licencës në ndonjërin nga gazetatat ditore apo mediet elektronike. Kopja e publikimit i bashkëngjitet shkresës me të cilën i licencuari njofton OMK-në për humbjen e licencës.

6. Në rast të dëmtimit të licencës, i licencuari do të njoftojë me shkrim OMK-në dhe me këtë rast do t'i bashkëngjitë shkresës së tillë ekzemplarin e dëmtuar të licencës, në qoftë se kjo është e mundur. Në rast se ekzemplarit të dëmtuar nuk i ka mbetur asnjë pjesë e cila vërteton dëmtimin e saj, i licencuari konsiderohet se ka përmbushur detyrimin me dorëzimin e shkresës në të cilën sqaron pamundësinë e dorëzimit të ekzemplarit të dëmtuar të licencës.

Neni 24

Dokumenti i licencës dhe faksimilja

1. Dokumenti i licencës së punës i lëshohet të licencuarit së bashku me faksimilen unike të të licencuarit.
2. Dokumenti i licencës përmban të dhënat si në vijim:
 - 2.1 Pjesën hyrëse, në të cilën shënohet baza juridike e lëshimit të licencës;
 - 2.2 Emri dhe mbiemri i të licencuarit;
 - 2.3 Titulli profesional, përfshirë këtu specializimin apo subspecializimin;
 - 2.4 Data dhe vendi i lindjes;
 - 2.5 Numri i diplomës apo certifikatës së specializimit;
 - 2.6 Numri i licencës;
 - 2.7 Data e lëshimit dhe data e skadimit të licencës;
 - 2.8 Numri personal; dhe
 - 2.9 Nënshkrimi i kryetarit të OMK-së dhe kryetarit të Komisionit për Licencim.
3. Me rastin e lëshimit të licencës, të licencuarit i dorëzohet faksimilja, e cila shërben si shenjë e identifikimit profesional.
4. Faksimilja ka këtë përmbajtje:
 - 4.1 Akronimin e OMK-së "OMK";
 - 4.2 Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit;
 - 4.3 Titullin profesional për të cilën është licencuar; dhe
 - 4.4 Numrin e licencës.
5. Madhësia dhe lloji i shkronjave në faksimile përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të OMK-së.
6. Pronar i faksimiles është OMK-ja dhe me rastin e skadimit të licencës, i licencuari është i obliguar që ta dorëzojë faksimilen.
7. Të dhënat që evidentohen në regjistrin e anëtarësisë së Odës, regjistrin e licencimit dhe rilicencimit, dokumentit të licencës dhe ato në faksimile, sa u përket të dhënave personale, përfshirë këtu emrin dhe mbiemrin dhe të dhënat e tjera relevante, do të bazohen në dokumentin e lëshuar nga organi i gjendjes civile, i cili nuk do të jetë më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj apo letërnjoftimit me afat valid.

Neni 25

Licenca për specializime të shumëfishta

1. Të licencuarit, i cili është i specializuar në më shumë se një lëmi specialistike apo subspecializime, për secilin specializim i lëshohet licencë e veçantë.
2. Licencat për secilin specializim të veçantë kanë numër unik identifikues dhe si të tilla janë dokumente të veçanta për të cilat poseduesi i tyre ka përgjegjësi për secilën nga to.

Neni 26 Kopja dublikate

1. Me kërkesë të mjekut anëtar, Komisioni mund të lëshojë licencë dublikate, në kopjen e së cilës do të shënohet evidenca se kopja e lëshuar është publikim i aktit të licencës. Me këtë rast Komisioni do të lëshojë licencën dublikate në afat të përputhshëm me afatin e licencës për të cilën është lëshuar ekzemplari dublikatë.
2. Parashtruesi i kërkesës për lëshim të ekzemplarit dublikatë të licencës është i obliguar që të paguajë taksën administrative për këtë shërbim në përputhje me vendimin e Kuvendit të Odës përkitazi me sistemin e taksave dhe tarifave administrative.

Neni 27 Taksat administrative

1. Taksa administrative për licencim caktohet në vlerë nominale në shumë totale për 5 (pesë) vite të vlefshmërisë së licencës. Taksa administrative caktohet po ashtu edhe për iniciimin e procedurës së licencimit dhe rilicencimit.
2. Taksa administrative caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të OMK-së.
3. Taksa administrative për regjistrim dhe anëtarësim caktohet sipas vendimit të Kuvendit të OMK-së.
4. I licencuari, krahas pagesës së taksës administrative për licencë, është i obliguar që të paguajë taksën administrative për lëshim të faksimiles.

Neni 28 Gjobat administrative

1. Në rastet e vonesave për licencim sipas afatit të paraparë me nenin 12 të kësaj Rregulloreje, Komisioni për Licencim do të aplikojë gjobë shtrënguese për vonesë të përmbushjes së detyrimit. Në rastin e tillë do të aplikohet gjoba në lartësi prej 10 (dhjetë) për qind të vlerës së pagës minimale të caktuar me vendim të Qeverisë së Kosovës.
2. Gjoba administrative, sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund t'i shqiptohet aplikuesit për periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj në total.

3. Gjoha administrative caktohet në vendim të Komisionit për Licencim, i cili nxirret në pajtim me nenin 18 të kësaj Rregulloreje.
4. Vendimi me të cilin është caktuar gjoha administrative do të përmbahet sipas rregullave të procedurës së përgjithshme administrative përkitazi me përmbahimin e akteve administrative.

Kapitulli V - Dispozitat përfundimtare

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e Brendshme e Punës së Komisionit për Licencim.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së

Prishtinë, 17 janar 2019

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sc.





SHTOJCA I

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

FORMULARI PËR ANËTARËSIM

I. Të dhëna personale

(TË DHËNAT DUHET TË SHËNOHEN ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT)

Emri, emri i prindit dhe mbiemri			
Data e lindjes	Dita:	Muaji:	Viti:
Vendlindja			
Numri personal		Shtetësia	
EM i pagës (për sektorin publik)			
Emri dhe adresa e institucionit shëndetësor/Ordinancës/Klinika			
Statusi profesional/specialistik			
Kodi i Licencës			

II. Adresa aktuale

Adresa	
Qyteti	
Kodi postar	

III. Të dhënat e komunikimit

Numri i telefonit të zyrës	
Numri i telefonit mobil	
Email adresa	

IV. Dokumentet e nevojshme

1. Tri (2) fotografi me dimensione 3cm x 4cm,
2. Kopjen e letërnjoftimit,
3. Kopjen e noterizuar të licencës,
4. Formulari për regjistrimin dhe specifikimin e të dhënave personale (të mbushet komplet),
5. Kopja e diplomës së studimeve dhe dëshmi të tjera, të cilat vërtetojnë specializimin/aftësimin profesional dhe kualifikimin e cituar në formularin për regjistrimin dhe specifikimin e të dhënave personale.
6. Dëshminë e pagesës pesë (5) euro për regjistrim në regjistrin e anëtarësisë.

Të dhënat personale të deklaruara në këtë formular përpunohen në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Deklaratë

Unë, i lartshënuari me të dhënat personale, e plotësoj këtë formular për anëtarësim, për të përmbushur detyrimin ligjor për anëtarësim në Odën e Mjekëve të Kosovës, në pajtim me dispozitat e nenit 8, të Ligjit nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësorë. Po ashtu deklaroj nën përgjegjësinë time civile dhe penale se të dhënat e shënuara më lart janë autentike dhe për deklarimin e tillë kam përgjegjësi ekskluzivisht personale.

Vendi	Data	Nënshkrimi



KOMISIONI PËR LICENCIM

**Numri i licencës:
(në rast të aplikimit për rilicencim
apo licencim specialistik)**

[illegible]

Aplikacioni është dorëzuar ☐ Licencim i përgjithshëm ☐ Licencim specialistik për:
☐ Rilicencim i përgjithshëm ☐ Rilicencim specialistik

TË DHËNAT E MËPOSHTME SHËNOHEN PERSONALISHT NGA PARASHTRUESI I APLIKACIONIT
(Të dhënat të shënohen me shkronja të shtypit)

Emri,emri i prindit dhe mbiemri		
Data dhe vendi i lindjes		
Numri personal		
Adresa		
Numri i telefonit		
Vendi dhe data e diplomimit		
Detaje mbi vendin e punës	Emri i institucionit shëndetësor	
	Data e punësimit dhe vendi	
	Specializimi	
	Data e specializimit	

Deklaroj se të dhënat e lartshënuara janë të vërteta dhe për deklarimin e tyre mbaj përgjegjësi penale dhe civile.

Të dhënat personale të deklaruara në këtë formular përpunohen në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Anëtar i Odës	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi	Data
PO / JO (të rrumbullakohet)			

Plotësohet nga personi i autorizuar i OMK-së

Dokumentacioni për aplikim:			
Licencim të përgjithshëm	Rilicencim i përgjithshëm	Licencimi specialistik/subspecialistik	Rilicencimi specialistik/subspecialistik
Aplikacioni	Aplikacioni	Aplikacioni	Aplikacioni
Diploma universitare (kopje e noterizuar)	Certifikata e valorizimit të pikëve kredituese nga KEVP-ja	Diploma universitare (kopje e noterizuar)	Certifikata e valorizimit të pikëve kredituese nga KEVP-ja
Certifikata e provimit të licencës (kopje e noterizuar)	Licenca e skaduar	Certifikata e provimit specialistik/subspecialistik (kopje e noterizuar)	Licenca specialistike/subspecialistike e skaduar
Kopja e letërnjoftimit	Kopja e letërnjoftimit	Kopja e letërnjoftimit	Kopja e letërnjoftimit
Fletëpagesa	Fletëpagesa	Fletëpagesa	Fletëpagesa

Afati i shqyrtimit të kërkesës: Dy javë nga data e dorëzimit

Në rast se aplikuesi nuk është anëtar i OMK-së, personi zyrtar vërteton parashtrimin e formularit për anëtarësim në OMK dhe përmbushjen e obligimeve statutoire për anëtarësim.

☐ **Parashtruar Formulari për anëtarësim**

☐ **Anëtar**

Personi i autorizuar i OMK-së

Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi	Data

V.V.

FORMULARI PËR ÇANËTARËSIM

I. Të dhëna personale MËDHA TË SHTYPIT)

(TË DHËNAT DUHET TË SHËNOHEN ME SHKRONJA TË

Emri,emri i prindit dhe mbiemri			
Data e lindjes	Dita:	Muaji:	Viti:
Vendlindja			
Numri personal			
Shtetësia			
Statusi profesional/specialistik		Nr. i licencës	
Numri i kartelës së anëtarësisë në OMK			

II. Adresa aktuale

Adresa	
Qyteti	

III. Të dhënat e komunikimit

Numri i telefonit	
Email- adresa	

Arsyet e parashtrimit të kërkesës për çanëtarësim

--

Deklaratë

Unë, i lartshënuari me të dhënat personale, e plotësoj këtë formular për çanëtarësim për arsyet e lartcekura. Deklaroj nën përgjegjësinë time civile dhe penale se të dhënat e shënuara më lart janë autentike dhe për deklarimin e tillë kam përgjegjësi ekskluzivisht personale, përfshirë këtu edhe përgjegjësinë për arsyen e deklaruar për çanëtarësim të deklaruar në këtë formular.

Vendi	Data	Nënshkrimi